



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 prill 2016
Nr. ref.:RK923/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI40/15

Parashtrues

Fatlume Meta

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit,
P. nr. 35/10, të 4 prillit 2011**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Fatlume Meta nga Magura, komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga z. Safet Krasniqi gjithashtu nga Magura, komuna e Lipjanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit (P. nr. 35/10, të 4 prillit 2011), të cilin ajo nuk e ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Ajo pohon se Aktgjykimin e ka pranuar, më 12 mars 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur nenin 20 [Shtyrja e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe me burgim afatgjatë] të Ligjit, Nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (në tekstin e mëtejme: Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale).
4. Parashtruesja e kërkesës nuk i referohet ndonjë të drejte dhe lirie të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) që mund të jetë shkelur.
5. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, gjegjësisht ta shtyjë vuajtjen e dënimit me burg.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 30 mars 2015, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 2 prill 2015, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi autorizimin për avokatin z. Safet Krasniqi, me të cilin e autorizoi atë që ta përfaqësojë në Gjykatë. Të njëjtën ditë, parashtruesja e kërkesës dorëzoi një letër shtesë, me të cilën kërkoi nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme.
9. Më 4 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI40/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI40/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Artta Rama Hajrizi.
10. Më 10 prill 2015, parashtruesja e kërkesës dorëzoi një letër tjetër në Gjykatë duke kërkuar nga kjo e fundit *“[...] ta shtyjë vuajtjen e dënimit me burg, t'i shqiptojë dënim më të butë, apo ta zëvendësojë atë me dënim me kusht”*.

11. Më 14 prill 2015, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ajo të dorëzojë vendimin e kontestuar dhe dokumentet e tjera relevante në Gjykatë.
12. Më 14 maj 2015, Gjykata i dërgoi një tjetër shkresë parashtrueses së kërkesës, me të cilën e informoi atë se në rast se ajo nuk dorëzon dokumentet e kërkuara brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve nga marrja e kësaj shkrese, Gjykata do të vazhdojë procedurën në bazë të shkresave ekzistuese të lëndës.
13. Më 1 qershor 2015, parashtruesja e kërkesës iu përgjigj shkresës së Gjykatës mirëpo nuk dorëzoi dokumentet e kërkuara. Në vend të tyre, parashtruesja e kërkesës dorëzoi një raport shëndetësor të fëmijës së saj.
14. Në mënyrë që të vërtetohen pretendimet e parashtrueses lidhur me datën e dorëzimit të vendimit të kontestuar, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të paraqesë prova se kur gjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses.
15. Gjykata Themelore në Prishtinë është përgjigjur në kërkesën e Gjykatës, mirëpo nuk dërgoi dokumentacionin e kërkuar por vetëm fletëkthesën e një vendimi tjetër të cilin nuk e konteston parashtruesja dhe, i cili nuk ekziston në shkresat e lëndës.
16. Më 6 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Parashtruesja e kërkesës ishte akuzuar për vepër penale, ishte shpallur fajtores dhe ishte dënuar me 1 (një) vit burgim.
18. Më 12 mars 2015, Gjykata Komunale në Prishtinë (ED. nr. 51/2012) nxori një urdhër, me të cilin ishte kërkuar nga parashtruesja e kërkesës që të fillojë vuajtjen e dënimit me burgim.
19. Më 20 mars 2015, parashtruesja e kërkesës i dërgoi një letër Gjykatës Komunale në Prishtinë, me të cilën kërkoi që t'ia shtyjë vuajtjen e dënimit me burgim.
20. Më 23 mars 2015, parashtruesja e kërkesës i dërgoi një letër tjetër Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar që t'i shtyhet vuajtja e dënimit me burgim, për një kohë të pacaktuar.
21. Më 26 mars 2015, parashtruesja e kërkesës i dërgoi një letër të ngjashme Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së burgjeve, me të njëjtën kërkesë, përkatësisht që *“t'ia shtyjë vuajtjen e dënimit të saj me burgim deri në rritjen e fëmijës së saj.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesja e kërkesës nuk i referohet ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë e cila mund t'i jetë shkelur. Ajo vetëm pretendon se ka pasur shkelje të nenit 20 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
23. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesja e kërkesës pohon se Gjykata Komunale në Prishtinë i ka shkelur kërkesat procedurale të parashikuara me nenin 20 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, sepse kjo e fundit parasheh që *“shtyrja e dënimit duhet të bëhet deri sa fëmija të arrijë moshën 3 vjeçare dhe fëmija im [...] është vetëm 2 vjeç”*.
24. Në fund, parashtruesja e kërkesës konkludon duke kërkuar nga Gjykata si në vijim:

“[...] të më mundësohet pezullimi i dënimit për një kohë deri sa fëmija të bëjë një moshë më të madhe [...] por edhe fëmijët tjerë”.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
26. Në këtë mënyrë, Gjykata i referohet dispozitave vijuese të Ligjit:

Neni 22.4 [Procedimi i kërkesës]

“4. Nëse kërkesa...nuk është ... e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, [...]”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar [...]”.

27. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 29 (2) [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullit 32 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

*“(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:
[...]
(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës”*.

“(5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është e jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose ta qartësojë kërkesën [...]”.

28. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e saj të garantuar me nenin 20 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, sepse ata nuk e kanë miratuar kërkesën e saj për të shtyrë vuajtjen e dënimit me burgim.
29. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesja e kërkesës nuk ka pretenduar asnjë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, të cilat mund të jenë shkelur.
30. Në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës të dorëzojë vendimin e kontestuar dhe vendimet tjera të gjykatave të rregullta.
31. Megjithatë, brenda afatit të caktuar, Gjykata nuk ka pranuar asnjë vendim të gjykatave të rregullta.
32. Gjykata konsideron se nuk mund të marrë parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës pa dokumente mbështetëse dhe prova materiale, në pajtim me nenin 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 29 (2) (h) dhe 32 (5) të Rregullores së punës.
33. Gjykata më tej konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar një rast *prima facie*, në mënyrë që Gjykata të vlerësojë përmbushjen e të gjitha kërkesave procedurale për pranueshmëri.
34. Përveç kësaj, Gjykata thekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se barra e përgjegjësisë bie mbi parashtruesen e kërkesës, që nuk ka arritur të përmbushë kriteret procedurale të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
35. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses nuk i përmbushë kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të mos kompletimit të kërkesës me dokumentacion relevant, ashtu siç kërkohet me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 29 (2) (h) të Rregullores së punës.
36. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër dhe prandaj është e papranueshme.

Kërkesa për Masë të përkohshme

37. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht *“t’ia shtyjë vuajtjen e dënimit të saj me burgim deri sa fëmijët e saj të rriten në moshë”*.
38. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk ka dorëzuar vendimin e kontestuar ose ndonjë vendim tjetër të gjykatave të rregullta dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se, pse Masa e përkohshme duhet të aprovohet.
39. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa për Masë të përkohshme nuk mund të zbatohet pasi ajo nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me Ligj dhe me Rregullore të punës.

40. Në mënyrë që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, nevojitet që:

“(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

*(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; ose
(...)*

Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës.”

41. Siç u konkludua më lart, kërkesa e parashtrueses është e papranueshme, dhe prandaj, nuk ka rast *prima facie* për vendosjen e Masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 27 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 29 (2) (h), 32 (5), 55 (4) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;
- III. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

